

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË

CILAT JANË IMPLIKIMET NGA MJETET PIROTEKNIKE
NË KOSOVË?



SOFIJE KRYEZIU

Prishtinë
Nëntor 2013

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij dokumenti të shkurtër të politikave është që të ofrojë një vlerësim në lidhje me rrezikun nga përdorimi i pakontrolluar i mjeteve piroteknike në Kosovë, duke sugjeruar marrjen e masave të nevojshme në drejtim të zvogëlimit të pasojave eventuale të cilat mund të shkaktohen nga ky fenomen. Sigurisht se për këtë argumenti bazohet nga këndvështrimi i sektorit të sigurisë, si rrjedhojë e implikimeve reale në rendin dhe sigurinë publike si dhe atë ambientale. Pavarësisht se ekziston baza ligjore, institucionet shtetërore nuk kanë krijuar kushtet bazë për parandalimin e incidenteve të mundshme. Në këtë drejtim nuk janë paraparë dhe ndërmarrë kampanja vetëdijësuese për mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike dhe efektet anësore - për shëndetin e njeriut, pasurinë, ambientin - botën bimore (ajrin dhe ujin) si dhe atë shtazore; nuk janë marrë masat e nevojshme për kualifikimin e personave që bëjnë tregtimin me këto mjete; nuk janë ndaluar shitjet pa leje; nuk mbrohen konsumatorët. Të gjitha këto fakte çojnë te përfundimi se siguria publike cenohet në masë të madhe nga mjetet piroteknike. Institucionet janë të udhëzuara që të marrin parasysh rekomandimet e këtij dokumenti në mënyrë që të sigurohet implementimi i mirëfilltë i kornizës ligjore ekzistuese.¹




Tabela 1. Trendi i sasisë së mjeteve piroteknike të importuara në Kosovë gjatë 10 viteve të fundit²(Doganat e Kosovës)

¹ Metodologjia e përdorur për draftimin e këtij dokumenti të shkurtër të politikave është bazuar në hulumtim kualitativ: vlerësimi i kornizës ligjore në nivel nacional dhe ndërkombëtar, zhvillimi i intervistave me aktorët relevant si dhe vlerësimi i raporteve të zhvilluara në këtë fushë.

² Për vitin 2013 të dhënat e janë të paraqitura deri me datën 21 Tetor 2013

GJETJET KRYESORE

- Kapacitetet vendore janë të kufizuara për parandalimin e incidenteve nga përdorim i mjeteve piroteknike dhe përgjigjes ndaj tyre në rast nevoje;
- Nuk ekziston mbrojtje adekuate e konsumatorëve - shpesh herë në praktikë edhe fëmijët nën moshën 12 vjeçare ndodh të shfaqen si blerës dhe përdorues të mjeteve piroteknike;
- Personat që i shesin mjetet piroteknike në Kosovë nuk i përmbushin kushtet bazë të parapara me legjislacionin për fushëveprimin e këtij biznesi;
- Dyshohet që mjetet piroteknike që hynë në tregun kosovar janë në shpërputhje me ato që në mënyrë taksative parashihen me ligj;
- Vërehet një mungesë e kujdesit prindëror në edukimin dhe dekurajimin e fëmijëve për përdorimin e këtyre mjeteve, gjë që vë në rrezik serioz mirëqenien dhe shëndetin e tyre.

2. SFONDI

Kosovarët janë përdorues të mëdhenj të mjeteve piroteknike. Statistikat zyrtare tregojnë se që nga viti 2004 mesatarja vjetore e importit të fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike është 1,1 milion kg.³ Kina është eksportuesi më i madh i mjeteve piroteknike në Kosovë (me mbi 50%), pasuar nga Bullgaria dhe Kroacia.⁴ Ekzistojnë fakte që tregojnë që sa më të lira që të jenë mjetet piroteknike aq më të dëmshme janë ato për shëndetin dhe ambientin. Duke vështruar nga ky aspekt edhe standardi i qytetarëve të Kosovës nuk lejon blerjen e mjeteve piroteknike cilësore. Për pjesën më të madhe të shteteve Evropiane, blerja e mjeteve piroteknike nuk

Mjetet piroteknike e kanë origjinën nga Kina qindra mijëra vite më parë, e cila njihet si njëra ndër shtetet më të mëdha për prodhimin, eksportimin dhe përdorimin e tyre. Pas saj, është zgjeruar përdorimi i mjeteve piroteknike dhe fishekzjarrëve edhe në pjesën tjetër të botës. Mirëpo, i gjithë ky proces çdo vit (që nga paraqitja e tij) ka ndikuar në dobësimin e kualitetit të jetës dhe humbjes së jetës së njerëzve. Vetëm në ShBA gjatë vitit 2012 mbi gjashtë persona kanë humbur jetën, 8,700 persona kanë përfunduar në emergjencat e spitaleve për trajtim nga lëndimet e shkaktuara nga fishekzjarrët. Prej tyre 1,000 janë lënduar nga fishekzjarrët që konsiderohen të parrezikshme për përdorim nga ana e fëmijëve.

³ QKSS, Email Intervistë me Z. Adriatik Stavileci, Zëdhënës në Doganat e Kosovës, data: 27 Nëntor 2013

⁴ QKSS, Intervistë me Z. Mensur Hoti, U.D. Drejtor i Departamentit për Siguri Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Prishtinë, data: 14 Nëntor 2013

i lejohet personave nën moshën 14, 16 dhe 18 vjeç, ndërsa në Kosovë ligjërisht blerja i lejohet fëmijëve që nga mosha 12 vjeçare, ndërkohë që në praktikë blerës ndodhë të jenë edhe fëmijët nën këtë moshë.

Përderisa biznesi me mjeteve piroteknike ngërthen përfitime jo të vogla për tregtarët, implikimet sa i përket sigurisë fizike dhe asaj ambientale janë të konsiderueshme. Vetëm gjatë tri viteve të fundit numri i rasteve të raportuara në polici si rezultat i dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i mjeteve piroteknike (nga viti 2010 deri në fillim të vitit 2013) përfshin mbi 34 persona të lënduar si dhe mbi 10 objekte të cilat janë djegur apo dëmtuar nga këto mjete. Në po këtë periudhë kohore në Qendrën Emergjente në Prishtinë janë lajmëruar mbi 220 raste të lëndimeve nga përdorimi i këtyre mjeteve.

2.1. KORNIZA LIGJORE

Përdorimi i mjeteve piroteknike rregullohet me anë të Ligjit Nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve i miratuar në fund të Korrikut të vitit 2011. Ky ligj përcakton kushtet dhe kriteret për prodhimin, tregtimin, importin, eksportin, transitin, transferimin, përdorimin dhe asgjësimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve si dhe kriteret për mbikëqyrjen dhe aplikimin e

Në ShBA gjithsej 8 shtete në masë të madhe e ndalojnë përdorimin e këtyre mjeteve, prej tyre janë: Iowa, Illinois, Ohio, Virginia janë katër shtete që lejojnë mjetet me rrezikshmëri shumë të ulët siç janë shkopinjtë vëzullues që lejohen edhe për përdorim brenda objekteve të banimit, kurse katër shtetet tjera si Delaware, Massachusetts, New Jersey, New York e ndalojnë plotësisht çdo lloj përdorimi të këtyre mjeteve.

këtij ligji me qëllim të mbrojtjes së individëve, pasurisë si dhe mjedisit. Me produkt piroteknikë i referohemi çdo produkti i cili përmban substancë apo përzjerje të substancave të dizajnuara që të lirojnë nxehtësi, dritë, zhurmë, gaz, tym apo kombinimi i tyre sjellë efekte përmes reaksioneve kimike, ekzotermike të vetë qëndrueshme për zbavitje dhe qëllime të tjera të cilat emërtohen si fishekzjarrë.⁵ Ligji për Përdorim Civil të Eksplozivëve i përmbahet legjislacionit ndërkombëtar në këtë fushë. Më konkretisht, ky ligj ndër tjerash është në pajtim me Marrëveshjen Evropiane për bartjen ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme përmes rrugës (ADR)⁶. Për sa i përket shitjes me pakicë, vetëm në shtator të vitit 2013 është nxjerrë Udhëzimi Administrativ për pikat e shitjes me pakicë të mjeteve piroteknike dhe fishekzjarrëve me të cilin

⁵ Ligji Nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve

⁶ Për më tepër informata ju lutem klikoni në linkun në vijim: http://www.unece.org/trans/danger/publi/adr/adr_e.html

janë të përcaktuara kushtet teknike për objektet të cilat përdoren për shitjen me pakicë të këtyre mjeteve.

2.2. SFIDAT

Pavarësisht ekzistimit të legjislacionit përkatës që rregullon shitblerjen dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike dhe fishekzjarrëve në Kosovë, mund të konstatohet se në përgjithësi ka dobësi institucionale në parandalimin dhe trajtimin e incidenteve. Kapacitetet vendore për të iu përgjigjur nevojave dhe situatave me të cilat mund të ballafaqohen qytetarët janë mjaft të kufizuara. Duke filluar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), përkatësisht Autoriteti i Përgjithshëm i Inspektimit në kuadër të Departamentit për Siguri Publike i cili ka numër të kufizuar (pesë) të inspektorëve.⁷ Studimi ka identifikuar mungesë të njohurive bazike për mënyrën e tregtimit të këtyre mjeteve në mesin e tregtarëve të cilët u kanë devijuar kriteret të përcaktuara me legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar. Këto mjete janë shitur nga persona dhe biznese që jo gjithëherë kanë qenë të pajisur me leje. Madje, deri në gjysmën e dytë të vitit 2013 shitja e mjeteve piroteknike me pakicë është realizuar pavarësisht që nuk kishte ndonjë bazë ligjore që e rregullon atë. Në këtë drejtim duhet cekur që mjetet piroteknike janë shitur pa përfillur distancën nga pikat e shitjes (ku nuk lejohen shitjet pranë institucioneve publike, religjioze, shkollave e të ngjashme) dhe pa plotësuar kushtet teknike siç janë: objektet për shitjen e këtyre produkteve, aparate për fikjen e zjarrit e të tjera të përcaktuara me legjislacionin vendor. Nuk është respektuar mosha të cilës i lejohet blerja e kategorive të lejuara të fishekzjarrëve. Vlen të ceket që Neni 15 i Ligjit për Përdorim Civil të Eksplozivëve përcakton kategoritë e mjeteve piroteknike dhe nivelin e rrezikut të tyre, ku parashihet që mosha minimale të cilës ju lejohet blerja e këtyre mjeteve (sipas kategorizimeve të paracaktuara) është ajo 12 vjeçare. E megjithatë faktet nga terreni tregojnë të kundërtën, sidomos kur marrim parasysh evidencat e Qendrës Emergjente në Kosovë ku vërehet se janë pikërisht të miturit nga 7-12 vjet viktimat më të shpeshta të incidenteve me mjete piroteknike. Ngjashëm, edhe në rastin e trajtimit të incidenteve janë vërejtur kapacitete të kufizuara. Qendra Emergjente në Prishtinë ka kapacitete të kufizuara për të iu përgjigjur situatave, shkaku i numrit të kufizuar të shtretërve⁸ që shikuar nevojat dhe kërkesat në periudhën e tri viteve të fundit kanë qenë të pamjaftueshme për të iu përgjigjur nevojave të qytetarëve.

⁷ QKSS, Intervistë me Z. Mensur Hoti, U.D. Drejtor i Departamentit për Siguri Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Prishtinë, data: 14 Nëntor 2013

⁸ Qendra Emergjente në Prishtinë ka vetëm 23 shtretër.

3. IMPLIKIMET NDAJ RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Në çdo fundvit në Kosovë dhjetëra qytetarë përfundojnë në Qendra Emergjente shkaku i lëndimeve të marra nga përdorimi i mjeteve piroteknike. Kjo për arsye se nuk ekziston një vetëdije e plotë e qytetarëve për përdorimin e atyre mjeteve si rezultat i mungesës së mbrojtjes së konsumatorëve dhe përcaktimit të qartë të mënyrës së përdorimit të atyre mjeteve. Viktima të lëndimeve nga këto mjete deri me tani kanë qenë kryesisht gjeneratat e reja, respektivisht moshat nga 7 deri me 18 vjet.⁹ Problematikë në këtë drejtim është vërejtur të jetë edhe keqpërdorimi me mjete piroteknike nga persona të moshave të reja, kryesisht meshkuj, të cilët eksperimentojnë duke kombinuar mjetet piroteknike për krijimin e një efekti të tingullit/zhurmës më të madhe e që në raste të pakujdesisë mund të ketë pasoja të mëdha sa i përket incidenteve/lëndimeve. Përpos lëndimeve fizike, një pjesë e caktuar e qytetarëve përballen edhe me pasoja psiko-sociale. Duke qenë se Kosova jo shumë kohë më parë është përballur me një ambient lufte si rezultati i një konflikti të armatosur, përdorimi i mjeteve piroteknike mund të prodhojë efekte të kthimit të kujtesës së pavullnetshme (ri-përjetimi i një eksperiencë të kaluar) që ndikon në aspektin emocional tek qytetarët e traumatizuar dhe që ndikon negativisht tek perceptimet e tyre në lidhje me ambientin në të cilin ata jetojnë. Po ashtu, shikuar nga aspekti i sigurisë ambientale përdorimi i mjeteve piroteknike ndikon edhe në shkatërrimin e botës bimore, ndotë ajrin si dhe kontaminon ujin gjë që mund të sjellë pastaj edhe pasoja shëndetësore tek njerëzit.¹⁰ Si dhe në aspektin ekonomik, përdorimi i mjeteve piroteknike mund të ketë për pasojë edhe në zjarr-vënie aksidentale dhe demelimin e objekteve të ndryshme qofshin ato publike apo private.

3.1. SIGURIA NJERËZORE - Rrezikimi i Sigurisë Personale

Përdorimi i mjeteve piroteknike më së tepërmi rrezikon sigurinë personale të individëve. Në raste më të 'lehta' mund të shkaktohet dëmtimi i shëndeti fizik dhe psikologjik të individëve, kurse në rastet më të rënda, edhe të shkaktohet vdekja e tyre. Disa prej problemeve shëndetësore që shkaktohen nga përdorimi i mjeteve piroteknike janë: lëndimet si dhe gjymtimi

⁹ QKSS, Intervistë me Z. Mensur Hoti, U.D. Drejtor i Departamentit për Siguri Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Prishtinë, data: 14 Nëntor 2013

¹⁰ Për më shumë informata ju lutem klikoni në linkun në vazhdim: http://www.backcountryattitude.com/toxic_fireworks.html, shikuar për herë të fundit me 22 Nëntor 2013

trupor, problemet kardiovaskulare, dëmtim i dëgjimit, humbja e shikimit, shkaktim i frikës, stresit, ndikime psiko-sociale dhe të ngjashme. Mjetet piroteknike janë mjete të rrezikshme të cilat në shumë raste mund të ndikojnë në krijimin e një ambienti jo të sigurt në vendin ku ato përdoren. Me përdorimin e tyre nga individ të thjeshtë gjatë festave të fund vitit, në rrethana të ndryshme janë shkaktuar pasoja shëndetësore dhe psikologjike të cilat kanë ndikuar në krijimin e një ambienti mjaftë kaotik.

3.1.1. EFEKTET SHËNDETËSORE

Rreziku shëndetësor i cili shkaktohet si pasojë e përdorimit të mjeteve piroteknike është i shumëfishtë. Në radhë të parë ekspozimi në ajrin e ndotur nga fishekzjarrët rrit rrezikun relativ të mortalitetit kardiovaskular për 125,11% dhe rreziku relativ për sëmundjet kardiovaskulare rritet për 175,16% në një ditë të zakonshme dimri.¹¹ Tymi nga fishekzjarrët është kryesisht i përbërë nga pluhuri toksik i cili lehtë mund të depërtojë në mushkëri e që paraqet një kërcënim të vërtetë për personat që vuajnë nga astma ose që kanë ndjeshmëri të shumëfishtë kimike (MCS).¹² Ndezja e fishekzjarrëve në Kosovë shkakton zhurma të mëdha, e që në shumë raste e tejkalojë 140 decibel të tingullit, ndërkohë që zhurmat në masë më të lartë se 85 decibel mund të shkaktojnë dëmtime të përkohshme apo edhe të përhershme të shqisave të dëgjimit.¹³ Përveç kësaj, përdorimi i mjeteve piroteknike ka rezultuar në shkaktimin e një numri të konsiderueshëm të lëndimeve, ku hyjnë vet-lëndimet si dhe lëndimet e palëve të treta të qytetarëve. Në tri vitet e fundit, pra nga viti 2010 e deri në fund të vitit 2012 (fillim të vitit 2013) mbi 220 raste të lëndimeve të qytetarëve të Prishtinës nga përdorimi i mjeteve piroteknike janë lajmëruar në Qendrën Emergjente në Prishtinë.¹⁴ Nga ky numër, 120 raste të lëndimeve janë raportuar të kenë ndodhur në vitin 2010, prej të cilave 97% kanë qenë raste të lehta, kryesisht të ekstremiteteve të sipërme dhe 3% raste të rënda që kanë rezultuar në humbjen e gjymtyrëve. Në vitin 2011 numri i incidenteve ka qenë 70 dhe vitin vijues (2012) ky numër ka arritur shifrën 33. Moshë e cila kryeson listën e lëndimeve është kryesisht mosha e re, 7 deri 18 vjeç, përkatësisht 7 deri 12 vjeç, përderisa meshkujt e kryesojnë listën e personave që pësojnë më tepër aksidente të kësaj natyre.

¹¹ B. Thakur, "Air pollution from fireworks during festival of lights (Deepawali) in Howrah, India - a case study", *Atmosfera*, Vol 23, No 4, 2010

¹² Fireworks - Cheap Thrills with Toxic Consequences, linku: http://www.backcountryattitude.com/toxic_fireworks.html, shikuar për herë të fundit me 20 Nëntor 2013

¹³ Noise Induced Hearing Loss NIHL, <http://www.dangerousdecibels.org/education/information-center/noise-induced-hearing-loss/>, shikuar për të fundit herë me 22 Nëntor 2013

¹⁴ QKSS, Intervistë me Sci. Dr. Basri Lenjani, Drejtor i Qendrës Emergjente, Qendra Emergjente, Prishtinë, data: 13 Nëntor 2013

Viti:	2010	2011	2012
Lëndime trupore:	120 persona	70 persona	33 persona

Tabela 2. Numri i incidenteve të raportuara në Qendrën Emergjente në Prishtinë

Në anën tjetër, në Policinë e Kosovës gjatë festave të fund-vitit në nivel nacional janë raportuar gjithsej 34 raste të lëndimeve të personave në tri vitet e fundit. Në fundin e vitit 2010 gjithsej 15 persona janë raportuar të kenë pësuar lëndime nga mjetet piroteknike.¹⁵ Vitin vijues (2011) gjithsej 11 persona janë raportuar të jenë lënduar nga këto mjete.¹⁶ Në fund të vitit 2012 janë raportuar gjithsej gjashtë (6)¹⁷ raste të lëndimeve nga mjetet piroteknike, si dhe një person ka humbur jetën si pasojë e zjarrit që dyshohet të jetë shkaktuar nga mjetet piroteknike.¹⁸

Viti:	2010	2011	2012
Lëndime trupore:	15 persona	11 persona	8 persona

Tabela 3. Numri i rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës

3.1.2. EFEKTET PSIKOLOGJIKE

Shikuar nga perspektiva psikologjike është vërejtur që plasjet e ndryshme të shkaktuara nga mjetet piroteknike ndikojnë negativisht tek qytetarët e thjeshtë të një vendi. Kjo gjë vërehet sidomos në rastin e Kosovës duke marrë për bazë kontekstin e luftës së fundit në Kosovë. Perceptimi është që qytetarët kanë nevojë të dinë që jetojnë në një ambient të sigurt e të kulturuar dhe përdorimi i mjeteve piroteknike gjatë festave nuk e japin këtë ide tek individët mesatar të shoqërisë. Për ta, zhurmat e këtilla e krijojnë ndjesinë e një vendi i cili ndodhet në kaos, ku nuk ka kontroll, ku shtresat e ndryshme të shoqërisë përfshirë edhe fëmijët shprehin agresivitetin si dhe destruktivitetin e tyre, duke i lejuar ata që të shprehen lirshëm pa pengesa dhe në mënyrë aspak adekuate, gjë që krijon imazh të keq për sjelljet e tyre.¹⁹ Andaj si rezultat kjo lloj situatë zakonisht asocohet me idenë e një shoqërie tolerante ndaj dhunës²⁰, gjë që bëhet pjesë e imazhit të qytetarëve ndaj vendit të tyre si një ambient i pasigurt.

¹⁵ Komunikatë për Media, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, Prishtinë, data: 01.01.2011

¹⁶ Komunikatë për Media, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, Prishtinë, data: 01.01.2012

¹⁷ Komunikatë për Media, Incidentet e raportuara gjatë ndërrimit të motmoteve 2012 – 2013, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, Prishtinë, data: 01.01.2013

¹⁸ QKSS, Intervistë me Z. Brahim Sadriu, Zëdhënës i Policisë së Kosovës, Prishtinë, data: 15 Nëntor 2013

¹⁹ QKSS, Intervistë me Prof. Ass. Dr. Dashamir Berxulli, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", data: 12 Nëntor 2013

²⁰ I referohet dhunës në shkollë, familje, përdorimit të armeve, vrasjeve për qëllime të dobëta.

Plasjet e ndryshme të shkaktuara nga mjetet piroteknike për kategori të caktuara të popullatës mund të jenë stimuj për të nxitur 'flashbacks²¹' (parafytyrimet i ngjarjeve të kaluara) - në rastin e personave që kanë përjetuar trauma dhe në rastin e atyre personave që kanë zhvilluar Çrregullimin e Stresit Post-Traumatik (ÇSPT) bazuar në këto trauma. Trauma është ngjarje e cila cenon integritetin fizik të individit në një shkallë apo tjetër, prandaj plasjet e ndryshme të krijojnë ngjarje të pasigurisë fizike, psikologjike e sociale. Duhet të i kushtohet një rendësi e veçantë dhe të kontrollohet komplet përdorimi i tyre sidomos kur është fjala për rastin e fëmijëve dhe njerëzve me probleme mendore. Nuk ekzistojnë statistika të sakta lidhur me efektet psikologjike të mjeteve piroteknike në Kosovë, megjithatë supozohet se përdorimi në masë të madhe i këtyre mjeteve ka pasur implikime tek një pjesë e qytetarëve, sidomos ata të moshës së re.

3.2. SIGURIA AMBIENTALE

Përbërja kimike e mjeteve piroteknike ka për efekt përkeqësimin e sigurisë ambientale, përkatësisht ka implikime para së gjithash në shëndetin e njeriut si dhe në ambientin, botën bimore dhe atë shtazore. Mjetet piroteknike përmbajnë substanca shkatërruese për ambientin. Pluhuri dhe tymi që shkaktohen nga ndezja e fishekzjarrëve mund të përmbajë një përzierje të përbërësve të squfurit-qymyrit, gjurmë të metaleve të rënda dhe kimikate të tjera toksike apo gazra.²² Ky tym i krijuar nga fishekzjarrët që përdoren nga ana e qytetarëve krahasuar me shfaqjet profesionale të organizuara është shqetësues për shkak se ato ndizen në nivel të ulët që lejon inhalim më të madh (e që përfshijnë dyoksid karboni (CO₂) dhe ozoni).²³ Disa prej elementeve toksike që janë pjesë përbërëse e mjeteve piroteknike qëndrojnë gjatë në ajër dhe mjedis duke kontaminuar ndër tjerash burimet ujore, përkatësisht ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore që shërbejnë qoftë për përdorim personal apo për bujqësi, blegtori e të ngjashme dhe që automatikisht ndikon në përkeqësimin e cilësisë së jetesës. Shikuar në kontekst të Kosovës, për sa i përket cilësisë së ajrit në këtë drejtim, nuk është bërë ndonjë studim i cili ka monitoruar apo analizuar cilësinë e ajrit dhe përmbajtjen toksike me rastin e ndezjes së fishekzjarrëve.

²¹ Flashback ose kujtesa e pavullnetshme e përsëritur, është një fenomen psikologjik ku individi papritur dhe fuqishëm ri-përjeton një eksperiencë të kaluar ose elemente të eksperiencës së kaluar.

²² Fireworks - Cheap Thrills with Toxic Consequences, linku: http://www.backcountryattitude.com/toxic_fireworks.html, shikuar për herë të fundit me 20 Nëntor 2013

²³ Po aty

3.3. SIGURIA EKONOMIKE - Rreziku i Shkaktimit të Dëmeve Materiale

Shikuar nga aspekti i efekteve negative që shkaktohen nga përdorimi qoftë i drejtë apo i gabuar i mjeteve piroteknike dhe kontaminimit të ajrit, botës bimore dhe ujit e të tjera lëndimeve ekzistojë edhe mënyra tjera të shkaktimit të dëmeve. Në këtë rast është fjala për dëmtimin e objekteve, qofshin ato private apo publike, dëmtime këto të e shkaktuara nga individët. Në Kosovë në tri vitet e fundit janë raportuar mbi 10 raste në Policinë e Kosovës të dëmtimit të pasurisë shkakui i përdorimit të gabuar të mjeteve piroteknike. Në vitin 2010 janë dëmtuar katër objekte, prej tyre tri objekte afariste dhe një pronë banimi, kurse në vitin 2012, janë shkaktuar katër dëmtime të veturave dhe një incident zjarri ku është djegur një objekt banimi me ç'rast një person ka humbur jetën.²⁴

Viti:	2010	2011	2013
Numri i objekteve të dëmtuara:	4	2	4

Tabela 4. Numri i incidenteve të raportuara në Policinë e Kosovës

4. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

Nuk ka dilemë se përdorimi i mjeteve piroteknike në Kosovë ka rezultuar në cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe shëndetësor. Studimi ka vërtetuar se nuk ekziston një mënyrë e informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve për modalitetet e përdorimit të këtyre mjeteve të rrezikshme. Për më shumë, nuk ekzistojnë kapacitetet bazë për parandalimin e incidenteve, e aq më pak për trajtimin e këtyre rasteve.

Nisur nga këto fakte, QKSS rekomandon masa radikale sa i përket çështjes së mjeteve piroteknike në Kosovë. QKSS është e vetëdijshme se rekomandimet si më poshtë do të mund të kenë implikime në biznesin dhe përfitimet e kompanive të caktuara megjithatë ne konsiderojmë se siguria fizike, ambientale dhe ekonomike duhet të mbizotërojë në raport me përfitimet materiale. QKSS rekomandon si më poshtë:

- Në mungesë të mekanizmave adekuat dhe funksional të ushtrimit të kontrollit institucional në lidhje me mënyrën e shitjes, periudhën kohore të shitjes, periudhën

²⁴ Komunikatat për Media, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, Prishtinë, datat: 01.01.2011, 01.01.2012 dhe 01.01.2013

kohore të përdorimit dhe mënyrës së përdorimit të tyre Qeveria e Kosovës duhet të ndalojë tërësisht shitjen, distribuimin dhe përdorimin e mjeteve piroteknike në Kosovë;

- Kjo masë duhet të mbulojë një periudhë kohore afatmesme 2 vjeçare ku deri në kthimin e këtyre mjeteve në treg, institucionet përkatëse do të ishin në gjendje të krijojnë mekanizmat përkatës mbikëqyrës. Po ashtu, deri atëherë do të ndërpritej edhe tradita e abuzimit me këto mjete nga ana e qytetarëve dhe si rrjedhojë implikimet do të ishin më të vogla;
- Në përputhje me vendimin për ndalimin e përkohshëm të këtyre mjeteve, Qeveria e Kosovës duhet të nxjerrë ndonjë akt ligjor që sanksionon shitësit e këtyre mjeteve në treg të zi përderisa kontrabanduesit e mundshëm të tyre të ndjeken në bazë të Kodit Penal të Kosovës;
- Me këtë akt ligjor, Qeveria e Kosovës do të marrë përsipër që gjatë periudhës ndaluese do ta krijojë gjithë bazën e nevojshme juridike dhe institucionale për të rregulluar dhe kontrolluar këtë fushë në bazë të standardeve të lejueshme bashkëkohore ndërkombëtare.

© E drejta e autorit

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo të ndryshohet pa lejen paraprake të botuesit. Opinionet e shprehura në publikimin e shkruar apo elektronik janë të autorit dhe të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Ky publikim nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e partnerëve të QKSS.

QKSS falënderon Fondacionin për Shoqëri të Hapur - Think Tank Fund që ka mundësuar këtë hulumtim. Përveç kësaj, duhet theksuar mbështetja e plotë institucionale e Think Tank Fondit në fuqizimin e kapaciteteve dhe aftësive të hulumtuesve të QKSS.

Redaktuar nga: Florian Qehaja dhe Mentor Vrajolli

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

662.1(496.51)

Kryeziu, Sofije

Cilat janë implikimet nga mjetet piroteknike në Kosovë /
Sofije Kryeziu. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të
Sigurisë, 2013. - 11 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm.

ISBN 978-9951-

ISBN 978-9951-8782-7-2



9 789951 878272